Kapet një armë në autobusin e linjës Itali-Kosovë

Foto: Policia e Kosovës (PK)

20 dhjetor 2023, 16:34

Shpërndaje në

Një revole me gaz është gjetur në bagazhin e një autobusi të udhëtarëve në pikën kufitare në Merdar, ka njoftuar Policia e Kosovës të mërkurën.

Autoritetet njoftuan se arma është gjetur në autobusin e kompanisë vendore të linjës Itali-Kosovë, e ajo ishte e fshehur në valixhe të udhëtarëve.



Arma është sekuestruar, ndërsa rasti është iniciuar si "import, eksport, furnizim, transportim, prodhim, këmbim ose shitje e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse".

"Më datën 20.12.2023 në ora 09:05 në Pikë Kalimin Kufitar në Merdar, në hyrje të Republikës së Kosovës, zyrtarë policorë kufitar së bashku me zyrtarët doganor gjatë kontrollimit në bagazhin e autobusit të një kompanie vendore, i linjës ndërkombëtare Itali-Kosovë, me vozitës m/k dhe ndihmës vozitës m/k kanë gjetur një armë (revole me gas), e cila kishte qenë e fshehur në një valixhe udhëtarësh", thuhet në njoftimin policor.

© KOHA. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalin tonë zyrtar në Viber

#ARME #LINJA NDERKOMBETARE #POLICIA E KOSOVES

Grabitje e armatosur në një pompë të derivateve në Kaçanik
Sulmohet një polic në veri
Babai rrah vajzën e tij, arrestohet
Plagosje në Fushë-Kosovë
Aksident në Rahovec, tre të lënduar
Digjet shtylla elektrike në Prizren
Policia po heton një vdekje të dyshimtë në Shtime

TaboolaFeed

Qetësoni dhimbjen e kockave dhe të muskujve në kushte shtëpie
Blog | Sponsored
Lexo më shumë

Diploma nga shtëpia, pa provime. Shihni opsionet
Studime në distancë | Search Ads | Sponsored

Disa keshilla ne lidhje me Psoriasis
Blog | Sponsored
Lexo më shumë

Ja disa këshilla në lidhje me dhimbjen e kockave
Blog | Sponsored
Lexo më shumë

Mbani në kontroll Psoriasis dhe Egzemën në kushte shtëpie
Blog | Sponsored
Lexo më shumë

Ai studioi me mësim në distancë në universitetet Amerikane
Studime në distancë | Search Ads | Sponsored

TË TJERA

Arrestohet serbi në Jarinjë, nuk posedonte dokumente për qenin që e kishte në veturë

Arrestohet i dyshuari për aksidentin në Podujevë ku humbi jetën një person

Arrestohet kosovari i dyshuar për vrasjen me thikë të një shtatzëne në Itali

Podujevë, një vajzë raporton se është rrahur nga njerka

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfardo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësive që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Përkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!